



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.487/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHEN TË BAZUARA ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.487/2025 dhe Anr.492/2025, të datës 09.02.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 Euro (dymijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.487/2025 nga subjekti politik LDK ne te cilën thekson se mbështetësit nga radhët e LVV-Izet Mexhiti, Bilall Kasami, Arben Taravari, Zeqirja Ibahimi, Niman Beqiraj, Agron Avdijaj (ish kandidat për kryetar në Istog nga radhët e LVV), Leutrim Ajeti (anëtar i LVV) e kane shkelur nenin 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i LZP-se dhe neni 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e postimit dhe thirrjeve per votim per subjektin politik LVV.

-Në ankesën Anr.492/2025 të datës 09.02.2025 të parashtruar nga subjekti politik LDK theksohet se LDK Dega ne Prishtine ka vërejtur se asambleistja e LVV ne Viti, e ka shkelur nenin 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i LZP-se dhe neni 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e postimit dhe thirrjeve per votim nga rrjeti i saj

social facebook. Bashkëngjitur gjeni provën që dëshmon për shkeljet e tilla të bëra në ditën e zgjedhjeve.

Si dëshmi ka bashkëngjitur provat për shkeljet e tilla të bëra në ditën e zgjedhjeve.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV për rastin Anr 487/2025 theksohet se personat në fjalë Izet Mexhiti, Bilal Kasami, Arben Tarvari dhe Zeqirija Ibrahim i konkretisht veprimet e tyre nuk mund të bien në domenin e PZAP për arsye se këto deklarime kanë ndodhur jashtë juridiksionit të Republikës së Kosovës dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen shkelje për arsye së heshtja zgjedhore vlen vetëm për territorin e Republikës, konsiderojmë bishtërim të ligjit dhe të drejtë të subjekteve jashtë RKS-së që edhe në ditën e zgjedhjeve të deklarohen lirshëm për qëndrimet e tyre. Fjalët "Votova" të subjekteve Niman Beqiraj dhe Leutrim Ajeti nuk bien ndesh me heshtjen zgjedhore sepse ligji në bazë të nenit 37 par 1.2 përcakton cka konsiderojmë shkelje gjatë kësaj kohe dhe përkufizon kështu: "bërja e fushatës në çfarëdo mënyre ". Dhe se përsëritja e shkronjës në asnjë formë nuk mund të quhet fushatë edhe nëse aludon në subjekt të caktuar sepse subjektet ekzistojnë edhe në heshtje veç se duhet të përmbahen nga veprimet me qëllim fushate. Fushata nënkupton avokimin, thirrjen për votim, mbledhje elektorale, tubime, posterë, reklama, slogane zgjedhore dhe jo citim të subjektit.

Ndërsa në përgjigje në ankesë për rastin Anr 492/2025 subjekti politik LVV kërkon nga PZAP-i që të refuzojë si të pathemeltë ankesën e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës lidhur me postimin në Facebook të znj. Liridona Bislimi, pasi që në postimin e saj, znj. Bislimi ka bërë thirrje për gratë që të shfrytëzojnë të drejtën e votës dhe kjo thirrje ka të bëjë me pjesëmarrjen e grave në demokraci, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Andaj bazuar në të lartcekurat e kësaj përgjigje në ankesë dhe pretendimet e palës ankuese kërkojnë nga PZAP-i që ankesat të refuzoj të pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: Anr.487/2025, dhe Anr.492/2025, të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.487/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara kundër subjektit të njëjtë politik LVV si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**- Ankesa është bazuar**

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale nga subjekti politik LDK ka gjetur se mbështetësit e subjektit politik LVV: Niman Beqiraj, Agron Avdijaj, Leutrim Ajeti dhe Liridona Bislimi, me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore dhe me qëllim të promovimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) gjatë ditës së votimit kanë bërë thirrje që të votohet subjekti politik LVV me numër 118 dhe kandidatet e saj, veprim ky që

është në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së ku përcaktohet se “1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”, andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe nga këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik LVV, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje ky subjekt e mohon shkeljen e bërë dhe thekson se heshtja zgjedhore vlen vetëm për territorin e Republikës, dhe se disa nga thirrjet nuk kanë pasur për qëllim të bëjnë thirrje për tu votuar subjekti politik LVV, për Panelin pretendimet e parashtruar në përgjigje në ankesë janë të bazuara për faktin se personat e cekur në ankesë Izet Mexhiti, Bilall Kasami, Arben Taravari, dhe Zeqirja Ibahimi janë qytetarë të shtetit tjetër - Maqedonisë së Veriut, dhe si të tillë nuk kanë të drejtë që të votojnë në vendin tonë e rrjedhimisht nuk mund të konsiderohen si mbështetës të subjektit politik në fjalë ashtu siç është përcaktuar në Ligjin e Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, andaj paneli nuk i mori për bazë pretendimet ankimore të palës ankuese sa i përket personave të lartcekur.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.487/2025, datë 11.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.